



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	06.10.2021
Referenc-ë:	07-353/04-205833/2/21
Për/ Za/ To:	Enes Bërveniku
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr. protokoll 07-353/04-205833/2/21 nga Enes Bërveniku me të cilën kërkohet që me datë 09.10.2021 nga ora 11:00 deri në 17:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” para shtatores.

Qëllimi i kërkesës është realizimi i ekspozitës të cilën e ka subvencionuar Komuna e Prishtinës gjegjësisht Drejtoria e Kulturës.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Enes Bërveniku për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 09.10.2021 nga ora 11:00 deri në ora 17:00 për realizimin e ekspozitës të cilën e ka subvencionuar Komuna e Prishtinës gjegjësisht Drejtoria e Kulturës.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.